



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 3494 Prot.

Tiranë, më 10/06/2020

URDHËR

Nr. 169, datë 10.06.2020

“PËR

**MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PARAQITJEN DHE  
TRAJTIMIN E SHPREHJEVE TË INTERESIT, SI DHE VERIFIKIMIN E  
PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE PËR ANËTARË TË BORDIT DISIPLINOR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 42, pika 4, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullave për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.
2. Procesi i paraqitjes, trajtimit të shprehjes së interesit dhe verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët, bëhet duke u bazuar në meritat e kandidatëve dhe duke respektuar parimet e përgjithshme të procedurës administrative.
3. Procedura e paraqitjes dhe shprehjes së interesit për anëtarë të Bordit Disiplinor, si dhe verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore dhe përzgjedhjes përfundimtare, sipas rregullave të këtij urdhri, bëhet për dy anëtarë që zgjidhen nga Ministri i Drejtësisë, dy anëtarë që zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme e Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe një anëtar që zgjidhet nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, që zbatojnë kërkesat lidhur me fazat e shpalljes dhe vlerësimit të kandidaturave sipas këtij urdhri.
4. Kërkesa për shprehje interesi të kandidatëve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe në atë të Shkollës së Magjistraturës për

- një anëtar që zgjidhet nga Këshilli Pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës, që zbatojnë kërkesat lidhur me fazat e shpalljes dhe vlerësimit të kandidaturave sipas këtij urdhri.
4. Kërkesa për shprehje interesi të kandidatëve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe në atë të Shkollës së Magjistraturës për kandidatin respektiv, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe qëndron e hapur për një periudhë prej 15 ditësh nga data e shpalljes.
  5. Kandidatët e interesuar duhet të depozitojnë me postë, dorazi në protokollin e institucionit apo në rrugë elektronike pranë institucionit përkatës dokumentacionin e mëposhtëm:
    - a) kërkesë për shprehje interesi;
    - b) jetëshkrim;
    - c) kopje të mjetit të identifikimit;
    - ç) diplomë që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi, ose diplomë të njësuar me të;
    - d) vërtetim nga punëdhënësi aktual apo ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore, shoqëruar me kopje të librezës së punës;
    - dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;
    - e) deklaratë se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe autorizimin përkatës për kryerjen e verifikimeve;
    - ë) deklaratë se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është noter në detyrë;
    - f) çdo dokument tjetër provues që vërteton plotësimin e kriterëve ligjore.
  6. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë institucionit përkatës është 10 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij urdhri.
  7. Në rast të mbarimit para kohe të mandatit të njërit prej anëtarëve, ndiqet e njëjta procedurë jo më vonë se 10 ditë pas marrjes dijeni për mbarimin e mandatit.
  8. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve fillon jo më vonë se 5 ditë nga mbarimi i afatit për dorëzimin e dokumentacionit dhe përfundon jo më vonë se 20 ditë nga data e nisjes.
  9. Për secilin kandidat që ka përcjellë shprehje interesi përgatitet relacion, me të cilin kandidati ka të drejtë të njihet në përfundim të procedurës administrative.

10. Ngritja e grupeve të brendshme të punës dhe organizimi i punës për kryerjen e procesit të vlerësimit të shprehjeve të interesit, deri në vendimmarrje, përcaktohen në përputhje me aktet e brendshme të titullarëve ose organeve drejtuese të institucioneve përkatëse.
  11. Pas procesit të vlerësimit, secilit kandidat i njoftohet vendimmarrja, së bashku me relacionin e përgatitur për kandidatin.
  12. Kandidatët e interesuar, kanë të drejtën e ankimit brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit sipas pikës 11 të këtij urdhri.
  13. Lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve publikohet përkatësisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Shkollës së Magjistraturës apo të Dhomës Kombëtare të Noterisë.
  14. Vendimi për kandidatin fitues, formalizohet me aktin përkatës administrativ të Ministrit të Drejtësisë, Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës apo Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit përkatës dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe i komunikohet njëkohësisht kandidatëve fitues dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
  15. Nëse kandidati fitues, sipas renditjes përfundimtare, tërhiqet, përzgjidhet kandidati i renditur menjëherë pas tij në listë.
  16. Në aktin administrativ përcaktohet data e fillimit të mandatit dhe data e mbarimit të tij, sipas ligjit për noterinë.
  17. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë.
  18. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyj në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI  
ETILDA GJONAJ (SALIU)

